Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Blerina Huruglica	**06.11.2024**	**18.11.2024**	**2024/1069**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 04.11.2024, **OE "N.T.SH. GIPA"- Prishtinë**, ka parashtruar ankesë me nr: **2024/1069,** kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "**FURNIZIM ME MATERIAL HIGJENIK**" me nr. të prokurimit: "**214-24-9026-1-1-1**", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues **(AK) – POLICIA E KOSOVËS.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: Furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 149,912.89 €.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 par.1 dhe 3 të ligjit nr.04/L-042 – Qëllimi.

Neni 7 par. 1 dhe 4 të ligjit nr.04/L-042 - Barazia në Trajtim Jo Diskriminimi.

Neni 41 i Rregullave dhe UOPP-së - Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve.

Neni 51 të LPP nr 04/L-042 - Njoftimi i kriterëve të Përzgjedhjes.

Neni 52 Par 4 i LPP nr 04/L-042 - Njoftimi i Kritereve për Dhënjen e kontratës.

Neni 56 te LPP-së nr.04/L-042 - Dispozitat e Përgjithshme mbi përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe

Dhënjen e kontratave.

Neni 59 par.2 dhe 4 të ligjit nr.04/L-042 - Ekzaminimi,Vlerësimi dhe Krahasimi i tenderëve

Neni 60 par.2 i Ligjit nr 04/L-042 Kriteret për dhënjen e Kontratës.

Neni 72 i LPP-së nr.04/L-042 – Dokumentacioni dhe Informacioni shtesë.

Neni 2, Neni 4, Neni 12 te RREGULLORES Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK

Operatori Ekonomik NTSH GIPA jemi OE i cili e plotëson çdo kriter te kërkuar ne FDT dhe jemi i vetmi ofertues i përgjegjshëm ne ketë aktivitet i prokurimit dhe jemi ofertuesi me çmimin me te ulet si kriter kryesor i cili e ruan dhe e mbron bugjetinë e shteti. Operatori Ekonomik NTSH GIPA pas vendimet për eliminim nga gara dhe anulimin e këtij aktiviteti te prokurimit i datës 29.10.2024 ne te njëjtën dite ne si OE kemi kërkuar qasje ne dokumentacion zyrtar. Është lejuar të qasemi ne dokumentet zyrtar më datën 30.10.2024 të gjitha kompanive te cilat kanë aplikuar ne këtë tender. Me datën 31.10.2024 AK ka pranuar kërkes per rishqyrtim, ku me datën 01.11.2024 ka marr vendim për refuzim te kërkesës per rishqyrtim. Sipas Autoriteti Kontraktues arsyeja e eliminimit tonë nga gara është e cekur si ne vijim: Pra eshte kërkuar: Shampon për makina 5 kg. Detergjent i bazuar në 15% substanca aktive,i rekomanduar për operacionet manuale të larjes. PH neutrale, delikate dhe e sigurt për çdo lloj bojë; heq papastërtinë për shkak të smogut, yndyrës, vajit dhe lloçit duke lënë sipërfaqe të pastra dhe të ndritshme. OE ka sjelle produktin me njësi matese Liter dhe jo kg sipas kërkese se AK dhe ne madhësi prej 10 litra. Përgjigja e OE: Sipas Ligjit për Prokurimin Publik, në veçanti Neni 72 i LPP-së nr. 04/L-042, është e nevojshme që të kërkohen informacione shtesë nëse janë identifikuar paqartësi në dokumentacionin e ofruesit. Ne kemi vërejtur se kjo procedurë nuk është zbatuar në rastin tonë, gjë që përbën një shkelje të ligjit dhe rregulloreve të prokurimit publik. Gjithashtu, ne si operator ekonomik, produktin te cilin ne e kemi doruzar Moster i plotëson te gjitha kriteret e përmbajtjes dhe substancave te kërkuara sipas normave dhe PH te cekura ne paramas. Të gjitha produktet e ngjashme janë të matshme në litra. Nëse do të ishim kontaktuar për informacione shtesë lidhur me këtë produkt, do të kishim qenë në gjendje të ofronim një deklaratë ku do të garantonim se produkti ynë mund të konvertohet në njësi matëse kilogram nëpërmjet një peshores standarde, dhe se gjatë furnizimit do të ofronim sasinë e kërkuar sipas kilogramëve, jo litrave.

Standardi i Matjes për Produktet e Lëngshme

Produkti në fjalë, shampo për makina, është një produkt në gjendje të lëngshme, për të cilin matja zakonisht bëhet në litra. Kjo është një praktikë standarde ndërkombëtare për produktet e kësaj natyre, pasi përmbajtja e tij llogaritet në volum dhe jo në peshë. Prandaj, përdorimi i litrit si njësi matjeje është e zakonshme dhe e përshtatshme për të gjithaproduktet e ngjashme në treg.

Konvertimi i Njësisë së Matjes nga Litra në Kilogramë

Duke qenë se shampo për makina mund të përkthehet lehtësisht në kilogramë për efekt të krahasimit. Ne jemi të gatshëm të ofrojmë detaje shtesë mbi këtë konvertim nëse kërkohet, por theksojmë se ndryshimi në njësi matjeje nuk ndikon në cilësinë apo përdorshmërinë e produktit.

Ndikimi në Ofertën e Përgjithshme

Produkti i lartpërmendur përbën vetëm rreth 20% të vlerës së përgjithshme të ofertës sonë.

Refuzimi i ofertës për shkak të këtij ndryshimi të vogël në formën e matjes së njësisë, sipas mendimit tonë, është disproporcional me ndikimin real që ky produkt ka në tenderin e plotë.

Rëndësia e keti tenderit për Mirëmbajtjen Higjienike

Duke marrë parasysh se produktet e kërkuara janë thelbësor për mirëmbajtjen higjienike të automjeteve dhe objekteve të Policisë së Kosovës, rëndësia e këtij produkti shkon përtej një njësie matës të thjeshtë. Duke përfshirë mbi 9,000 zyrtarë policorë, është e domosdoshme që standardet e larta higjienike të mbahen në vazhdimësi. Çdo vonesë në furnizimin e këtyre produkteve për arsye të një ndryshimi në njësi matjeje mund të rrezikojë mirëqenien dhe shëndetin e këtyre punonjësve dhe të dëmtojë mjedisin e përditshëm të punës.

Duke marrë parasysh si më sipër, kërkojmë mirëkuptimin tuaj për të rishikuar ofertën tonë, duke konsideruar fleksibilitetin në njësitë e matjes dhe

përputhshmërinë e produktit tonë me kërkesat e tenderit. Ne mbetemi të gatshëm të ofrojmë çdo informacion shtesë dhe të bashkëpunojmë për të siguruar plotësimin e nevojave te Policisë se Kosovës

Kërkoj nga OSHP qe ta shqyrtoj kërkesën tone dhe ta pranoj si te bazuar dhe te kthej ne rivlerësim te ndryshoj vendimin për anulim te keti aktivieteti te prokurimit dhe te shpërblej me kontratë Operatorin Ekonomik NTSH GIPA pasi qe është kompania me e përgjegjshme dhe i plotëson te gjitha kërkesat ne FDT.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesa 5 Operatorët Ekonomik ofertues duhet të dorëzojnë nga një moster për të gjithë artikujt që janë nën pjesën C (9 artikuj) mostrat duhete te jene paketim te prodhuesit.	**Dëshmi 5 Mostra duhen dorëzuar për të gjithë artikujt që janë nën pjesën C (9 artikuj) para datës së pranimit të ofertave ora 14 00.**

9	Shampon për makina 5 kg. Detergjent i bazuar në 15% substanca aktive,i rekomanduar për operacionet manuale të larjes. PH neutrale, delikate dhe e sigurt për çdo lloj bojë; heq papastërtinë për shkak të smogut, yndyrës, vajit dhe lloçit duke lënë sipërfaqe të pastra dhe të ndritshme.	copë	1

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:

Policia e Kosovës anulon aktivitetin e prokurimit ne munges te nje oferte te pergjegjeshme
Gjithashtu AK ne fazen e pergatitjese se aktivitetit (para Njoftimit per kontrate) ka leshuar nje gabim te Aneksi 1: Specifikacionet Teknike , artikulli 7:
Detergjent i lëngët për larjen e rrobave-prej 3 litra Përbërsit: 5-15% anionic surfactants; <**5%** ?
Teksti "<5% " mungon ne vazhdim dhe per kete arsye nuk mund te behet vlersimi ne harmoni me LPP.
Andaj duke bazuar në nenin 62. Pika 1.1 të LPP një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

/

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

/

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

/

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

/

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **N.T.SH. GIPA**

Aktiviteti i prokurimit me titull: "**FURNIZIM ME MATERIAL HIGJENIK**" me nr. të prokurimit: "**214-24-9026-1-1-1**", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues **(AK) – POLICIA E KOSOVËS, procedurë e hapur, lloji i kontratës furnizim, kriteri çmimi më i ulët i përgjegjshëm.**

AK me datë 29/10/2024 publikon njoftimin mbi vendimin B58- anulim të aktivitetit të prokurimit me arsyetimin:

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:

Policia e Kosovës anulon aktivitetin e prokurimit ne munges te nje oferte te pergjegjeshme
Gjithashtu AK ne fazen e pergatitjese se aktivitetit (para Njoftimit per kontrate) ka leshuar nje gabim te
Aneksi 1: Specifikacionet Teknike , artikulli 7:
Detergjent i lëngët për larjen e rrobave-prej 3 litra Përbërsit: 5-15% anionic surfactants; <**5%** ?
Teksti "<5% " mungon ne vazhdim dhe per kete arsye nuk mund te behet vlersimi ne harmoni me LPP.
Andaj duke bazuar në nenin 62. Pika 1.1 të LPP një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Data: 29/10/2024

Gjithashtu OE ankuesin e eliminon me arsyetimin:

OE ka deshtuar ne Aneksin 1 Specifikacionet Teknike
AK ka kerkuar ne pjesen C artikulli 9:
Shampon për makina 5 kg. Detergjent i bazuar në 15% substanca aktive,i rekomanduar për operacionet manuale të larjes. PH neutrale, delikate dhe e sigurt për çdo lloj bojë; heq papastërtinë për shkak të smogut, yndyrës, vajit dhe lloçit duke lënë sipërfaqe të pastra dhe të ndritshme.
OE ka sjelle produktin me njesi matese Liter dhe jo kg sipas kerkese se AK dhe ne madhesi prej 10litra.
Andaj OE eshte I papergjegjshem

Dhe rrjedhimisht, OE ankues i pakënaqur me vendimin e AK-së, si dhe me refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, i njëjti parashtron ankesë pranë OSHP-së, duke pretenduar se AK nuk ka vlerësuar drejtë ofertat dhe se gjatë vlerësimi të ofertave ka shkelë Ligjin për Prokurim Publik përkatësisht nenet: 1,7,51,52,56,59,60,72 si dhe Rregulloren për prokurim publik nr.001/2022 nenet:2, 4, 12, 41.

Pretendimi i OE ankues kundër arsyes së eliminimit:

Operatori Ekonomik NTSH GIPA jemi OE i cili e plotëson çdo kriter te kërkuar ne FDT dhe jemi i vetmi ofertues i përgjegjshëm ne ketë aktivitet i prokurimit dhe jemi ofertuesi me çmimin me te ulet si kriter kryesor i cili e ruan dhe e mbron buxhetin e shteti. Operatori Ekonomik NTSH GIPA pas vendimet për eliminim nga gara dhe anulimin e këtij aktiviteti te prokurimit i datës 29.10.2024 ne te njëjtën dite ne si OE kemi kërkuar qasje ne dokumentacion zyrtar. Është lejuar të qasemi ne dokumentet zyrtar më datën 30.10.2024 të gjitha kompanive te cilat kanë aplikuar ne këtë tender. Me datën 31.10.2024 AK ka pranuar kërkesë për rishqyrtim, ku me datën 01.11.2024 ka marr vendim për refuzim te kërkesës per rishqyrtim. Sipas Autoriteti Kontraktues arsyeja e eliminimit tonë nga gara është e cekur si ne vijim: Pra eshte kërkuar: Shampon për makina 5 kg. Detergjent i bazuar në 15% substanca aktive,i rekomanduar për operacionet manuale të larjes. PH neutrale, delikate dhe e sigurt për çdo lloj bojë; heq papastërtinë për shkak të smogut, yndyrës, vajit dhe lloçit duke lënë sipërfaqe të pastra dhe të ndritshme. OE ka sjelle produktin me njësi matese Liter dhe jo kg sipas kërkese se AK dhe ne madhësi prej 10 litra. Përgjigja e OE: Sipas Ligjit për Prokurimin Publik, në veçanti Neni 72 i LPP-së nr. 04/L-042, është e nevojshme që të kërkohen informacione shtesë nëse janë identifikuar paqartësi në dokumentacionin e ofruesit. Ne kemi vërejtur se kjo procedurë nuk është zbatuar në rastin tonë, gjë që përbën një shkelje të ligjit dhe rregulloreve të prokurimit publik. Gjithashtu, ne si operator ekonomik, produktin te cilin ne e kemi dorëzuar Moster i plotëson te gjitha kriteret e përmbajtjes dhe substancave te kërkuara sipas normave dhe PH te cekura ne paramas. Të gjitha produktet e ngjashme janë të matshme në litra. Nëse do të ishim kontaktuar për informacione shtesë lidhur me këtë produkt,

do të kishim qenë në gjendje të ofronim një deklaratë ku do të garantonim se produkti ynë mund të konvertohet në njësi matëse kilogram nëpërmjet një peshores standarde, dhe se gjatë furnizimit do të ofronim sasinë e kërkuar sipas kilogramëve, jo litrave.

Standardi i Matjes për Produktet e Lëngshme

Produkti në fjalë, shampon për makina, është një produkt në gjendje të lëngshme, për të cilin matja zakonisht bëhet në litra. Kjo është një praktikë standarde ndërkombëtare për produktet e kësaj natyre, pasi përmbajtja e tij llogaritet në volum dhe jo në peshë. Prandaj, përdorimi i litrit si njësi matjeje është e zakonshme dhe e përshtatshme për të gjitha produktet e ngjashme në treg.

Ekspertja shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës të publikuara në E-prokurim sqaron se, AK në DT për pozicionin nr. 9 ka kërkuar Shampon për makina 5 kilogram:

9	Shampon për makina 5 kg. Detergjent i bazuar në 15% substanca aktive,i rekomanduar për operacionet manuale të larjes. PH neutrale, delikate dhe e sigurt për çdo lloj bojë; heq papastërtinë për shkak të smogut, yndyrës, vajit dhe lloçit duke lënë sipërfaqe të pastra dhe të ndritshme.	copë	1

Kurse OE ankues në mostra ka sjellë shampon në sasinë 10 litra, mirëpo bazuar në kërkesën e AK-së e cila konsideroj se AK nuk ka përcaktuar saktë njësinë matëse për produktet e lëngshme, dhe sipas mendimit të ekspertes shqyrtuese produktet e lëngshme zakonisht maten me litër si njësi standard për matje. Mirëpo OE ankues ka sjellë sasinë 10 litra e cila është më tepër se 5 KG, atëherë ky detaj mund të konsiderohet si devijim i vogël, për faktin se njësia matëse dhe mostra me sasi më të madhe nuk ndryshon produktin e ofruar. **Pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar, e cila e cilëson ankesën si pjesërisht e bazuar.**

Rrjedhimisht, përkundër pretendimit të OE ankues, arsyeja e anulimit të aktivitetit të prokurimit është mos vendosja e saktë e specifikave në përbërjen e produktit për artikullin nr.7. Andaj sipas sqarimeve me lartë ekspertja shqyrtuese konsideron se meqenëse AK nuk ka vendosur saktë specifikat e produkteve të kërkuara, e po ashtu edhe njësive matëse, atëherë rekomandoj që të mbetet në fuqi vendimi i AK-së për anulim të aktivitetit të prokurimit.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **POLICIA E KOSOVËS**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **N.T.SH. GIPA**

REPUBLIKA E KOSOVËS
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
PRISHTINË/A
REPUBLIKA KOSOVA

Blerina Huruglica